

Një kafe për ndryshim: Studentët në Shqipëri së bashku me rrjetin e kafeneve sfidojnë stereotipet gjinore.

Data: 7 mars 2024

UN Women së bashku me studentët e Fakultetit të Shkencave Sociale në Shqipëri në bashkëpunim me rrjetin e njohur të kafeneve "Sophie Caffè", kanë nisur në "Ditën Ndërkombëtare të Gruas" fushatën që lufton stereotipet dhe diskriminimin gjinor. Kjo nismë fitoi çmimin e parë në "Bootcamp"-in e organizuar nga UN Women si pjesë e programit të përbashkët të OKB-së "Askush të Mos Mbetet Pas".

"Roli i punonjësve social në adresimin e diskriminimit gjinor e formave të tjera të shumëllojshme e të ndërthurura të diskriminimit" ishte tema e "Bootcamp"-it tre-ditor të organizuar në muajin tetor 2023 nga UN Women me pjesëmarrjen e 36 studentëve të Fakultetit të Shkencave Sociale. Në këtë aktivitet ata përforcuan njohuritë e tyre mbi perspektivat e barazisë gjinore, sfidat e diversitetit dhe përfshirjen e grupeve në nevojë. Të ndarë në pesë grupe, studentët patën mundësinë të zhvillonin idetë dhe konceptet e tyre për adresimin e nevojave të ndryshme të grave dhe vajzave vulnerabël në marrjen e shërbimeve të kujdesit social përmes një fushate ndërgjegjësuese.

"Synimi i këtij aktiviteti ishte të pajiste punonjësit e ardhshëm social me aftësi dhe njohuri të nevojshme përmes metodave të mësimit interaktiv, duke nxitur mendimin kritik dhe aftësitë e tyre për zgjidhjen e problemeve. Nisma kërkon të frymëzojë një brez të ri profesionistësh që të jenë në gjendje të sfidojnë diskriminimin gjinor në shërbimet sociale përmes projekteve dhe fushatave të ndërgjegjësimit." - tha Prof. Asoc. Dr. Eliona Kulluri, Shefe e Departamentit të Punës dhe Politikës Sociale, Fakulteti i Shkencave Sociale.

Ekipi i Arjolës, Gjeksikës, Sonjës, Klidias dhe Alketës solli idenë më inovative për promovimin e barazisë gjinore në komunitet përmes shpërndarjes së gotave të kafesë me mesazhe kundër diskriminimit dhe stereotipeve në vendin e punës. Tani idetë e tyre janë bërë realitet falë bashkëpunimit me "Sophie Caffè" që nga data 7 deri më 15 mars 2024, do të shpërndajë tek klientët e saj gota kafeje me mbishkrim mesazhe pozitive dhe që nxisin reflektim.

"Bootcamp"-i u organizua në bashkëpunim me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Avokatin e Popullit dhe stafin e Departamentit të Punës dhe Politikës Sociale.

"Ky partneritet thekson rolin e rëndësishëm të arsimit dhe angazhimit të komunitetit në ndryshimin sistematik. Përmes nismave si tryezat konsultative, forumet e hapura dhe "Bootcamp"-et e specializuara, studentët fuqizohen për të sfiduar normat, analizuar në mënyrë kritike konceptet e barazisë dhe diversitetit dhe për të zhvilluar fushata gjithëpërfshirëse", - u shpreh Erisa Çela, Menaxhere e Programit, UN Women Shqipëri.

“Bootcamp”-i prodhoi tre ide fituese dhe fushata ndërgjegjësuese, të cilat do të mbështeten nga programi i përbashkët i OKB-së "Askush të Mos Mbetet Pas", i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

Programi “Askush të Mos Mbetet Pas” i zbatuar në bashkëpunim nga UNDP, UNICEF, UN Women dhe UNFPA nga viti 2021 deri në 2025, synon të transformojë mbrojtjen sociale dhe gjithëpërfshirjen duke ofruar shërbime dhe mundësi thelbësore për komunitetet e marginalizuara, me qëllim sigurimin e të drejtave themelore të njeriut dhe dinjitetit të tyre.

"Fuqizimi i Zërave: Këndvështrimi i Advokuesve të Rinj për Barazinë Gjinore dhe Drejtësinë Sociale".

Fushata synon të rrisë ndërgjegjësimin për barazinë gjinore, diskriminimin gjinor për grupe të caktuara (duke përfshirë por pa u kufizuar tek të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, nënat beqare, komunitetin Rom dhe Egjiptian, komunitetin LGBTIQ+), gjuhën seksiste në mjediset e punës, etj.

Përmes kësaj nisme, ekipi fitues shpreson të inkurajojë pjesëmarrje aktive, të vendosë një platformë për diskutim dhe të promovojë qasje inovative për të rritur ndërgjegjësimin në grupet e synuara. Projekti vë në pah parimin "Askush të Mos Mbetet Pas" dhe synon të angazhojë edhe bizneset në fushatë për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të promovuar gjithëpërfshirjen.

Arjola Beshaj, studente në programin Master “Komunikim për Ndryshim Social dhe atë të Sjelljes”, beson në fuqinë e ndikimit dhe ndërgjegjësimin, duke advokuar për një qasje edukative që nxit gjithëpërfshirjen dhe empatinë që në moshën e hershme. *“Mesazhi im është: jeto lirisht në mendimet e tua duke respektuar mirëqenien emocionale dhe psikologjike të të tjerëve, duke nxitur kështu një shoqëri të lirë nga urrejtja dhe diskriminimi.”*

Gjeksika Doshi, studente në Administrim dhe Politika Sociale, thekson rëndësinë e promovimit të rolit udhëheqës për gratë dhe sfidën ndaj mendësive të vjetëruara gjinore brenda familjeve dhe shoqërisë. *“Unë shpresoj që fushata do të sfidojë stereotipet shoqërore dhe do të promovojë idenë se gratë mund të ndjekin karrierën por njëkohësisht mund të krijojnë familje. Mesazhi im është: zgjidhni empatinë përpara të gjithave, respektoni historinë të çdo individi.”*

Sonja Naslazi, studente në Administrim dhe Politika Sociale, thekson se mungesa e ndërgjegjësimin për barazi gjinore dhe diversitet është një çështje kritike. *“Unë besoj se ka një mungesë ndërgjegjësimi në lidhje me diskriminimin gjinor tek të rinjtë. Shumë studentë nuk janë të vetëdijshëm për konceptet si respekti ndaj diversitetit, barazisë dhe të drejtave gjinore. Marrja e njohurive është hapi i parë për ndryshim. Filloni të pranoni të drejtat e të tjerëve ashtu siç do të donit të pranoni tuajat, pa dallime gjinore.”*

Klidia Dimo, studente në Administrim dhe Politika Sociale, beson se projekti i tyre ka potencialin për të rritur ndërgjegjësimin në komunitet dhe për të inkurajuar institucionet në adresimin e çështjeve të barazisë gjinore. *“Mesazhi im për të rinjtë është: respektoni njëri-tjetrin dhe përpiquni*

të tregoni sa më shumë dashuri dhe kuptim ndaj të tjerëve, duke lënë mënjanë gjuhën e urrejtjes dhe të diskriminimit gjinor.”

Alketa Çollaku, studente Masteri në Shërbime Sociale në Drejtësi Penale, e sheh profesionin e saj si një mjet të fuqishëm për të përshpejtuar ndryshimet shoqërore, përmes advokimit për ndryshime pozitive dhe duke promovuar një kulturë të barazisë dhe respektit për të gjithë. *“Mesazhi im për të rinjtë sot është: Refuzoni fjalët e urrejtjes dhe diskriminimit gjinor dhe në vend të tyre promovoni një kulturë të respektit, dinjitetit dhe barazisë për të gjithë. Bëhuni aleatë në luftën kundër diskriminimit, kontribuoni në krijimin e një shoqërie më të drejtë dhe më të barabartë për të gjithë.”*

Bëhu pjesë e kësaj nisme dhe e ndryshimit duke postuar filxhanin tënd të kartonit me mesazhin në mediat sociale dhe duke bërë tag @unwomenalbania në Instagram, Facebook dhe X. UN Women Shqipëri do të ndajë të gjitha fotot tuaja.